



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P. 05/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.01.2019 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e shoqërive “Kevenjo” sh.p.k, “Anakonda Security” sh.p.k, “SSX” sh.p.k, “Res-03” sh.p.k, “Siguria” sh.p.k, “Pelikani Security Group” sh.p.k, “Safe” sh.p.k, “A-2000” sh.p.k, “Aulona Pol 1” sh.p.k, “Ballazhi” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Myrto Security” sh.p.k, “Snajper Security” sh.p.k, “Trezhnjeva” sh.p.k, “Oktapus” sh.p.k, “Oktapus 1 Security” sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k dhe “Leksi Security” sh.p.k, pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit “*Marrëveshje kuadër*” me Nr.REF-88414-10-03-2018 me objekt: “*Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private, te Drejtorisë së Rajonit Qendror Tirane*”, me fond limit 6.143.000 lek pa tvsh, zhvilluar ne daten 01.11.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Qendror Tirane.

**Ankimues:**

“Dea Security” shpk  
Rr. “Ndre Mjeda”, Qendra Polifunksionale, Kati I, Tiranë

**Subjekte të Interesuar:**

“Safe” sh.p.k  
Nj.B.11, Rr. "Bernard Bilota", K. "Haëai- Toëer" Nr.17, Pazar 2, Kat 1, Tiranë  
  
“A-2000” sh.p.k  
Rruga “Hamit Shijaku”, Banesa nr. 24, Tiranë

“Aulona Pol 1” sh.p.k  
Bulevardi Ismail Qemali, Lagjja Pavarësia, Pallati Riviera 2, Kati 3, Vlorë

“Ballazhi” sh.p.k  
Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Ali Kuka, banesa nr.183/1, Tirane

“Eurogjici Securiy” sh.p.k  
Rr. “Adem Jashari, L.nr 8,Nd. 4, H. 10, Ap 3, Njesia Bashkiake nr 5, Tiranë

“Myrto Security” sh.p.k  
Lagjja Kastriot, tek zyrat e Albtelecomit kati i 3-te, Fier

“Snajper Security” sh.p.k  
L.”Pjetër Budi”, Rruga “Kont Uran”, Burrel

“Trezhnjeva” sh.p.k  
Rruga Jaho Salihi, Pallati Nr.90/3, Shk. Nr.1, Ap. Nr.5. , Bajram Curri,

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Rajonit Qendror Tirane.  
Rr.Princ Vidi nr .18/3 Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve,

që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

## II

*Rrethanat e çështjes.*

II.1. Në datën 04.10.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr.REF-88414-10-03-2018 me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private, te Drejtorisë së Rajonit Qendror Tirane”, me fond limit 6.143.000 lek pa tvsh, zhvilluar ne daten 01.11.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Qendror Tirane.

II.2. Në datën 15.11.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Kevenjo” shpk	5.832.908,26 lekë	skualifikuar
2. “Anakonda Security” shpk	5.832.919,02 lekë	skualifikuar
3. “SSX” shpk	5.832.919,02 lekë	skualifikuar
4. “Safe” shpk	5.833.053,68 lekë	kualifikuar
5. “A-2000” sh.p.k	5.833.053,68 lekë	kualifikuar
6. “Aulona Pol 1” sh.p.k	5.833.053,68 lekë	kualifikuar
7. “Ballazhi” sh.p.k	5.833.053,68 lekë	kualifikuar
8. “Eurogjici Security” sh.p.k	5.833.053,68 lekë	kualifikuar
9. “Myrto Security” sh.p.k	5.833.053,68 lekë	kualifikuar
10. “Snajper Security” sh.p.k	5.833.053,68 lekë	kualifikuar
11. “Trezhnjeva” sh.p.k	5.833.053,68 lekë	kualifikuar
12. “Res-03” sh.p.k	5.833.053,68 lekë	skualifikuar
13. “Siguria” sh.p.k	5.833.053,68 lekë	skualifikuar
14. “Oktapus” sh.p.k	5.834.400,62 lekë,	kualifikuar
15. “Oktapus 1 Security”	5.834.400,62 lekë,	kualifikuar
16. “Toni Security” sh.p.k	5.834.400,62 lekë,	kualifikuar
17. “Leksi Security” sh.p.k	5.839.824,78 lekë,	kualifikuar
18. “Dea Security” sh.p.k	5.839.933,99 lekë,	kualifikuar
19. “Nazeri 2000” sh.p.k	5.839.933,99 lekë,	kualifikuar
20. “Pelikani Security Group” sh.p.k	5.839.933,99 lekë,	skualifikuar
21. “Çullhaj” sh.p.k	5.841.026,11 lekë,	kualifikuar
22. “Start 2000” sh.p.k	5.993.157,59 lekë,	kualifikuar

23. “Arbana Sh.A” sh.p.k s’ka paraqitur ofertë.

II.3. Operatori ekonomik “Dea Security” shpk, në datën 19.11.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

1. Nga ana e AK duhet të mbeten të skualifikuara shoqëritë “Kevenjo” sh.p.k, “Anakonda Security” sh.p.k, “SSX” sh.p.k, “Res-03” sh.p.k, “Siguria” sh.p.k, “Pelikani Security Group” sh.p.k, dhe duhet të skualifikohen shoqëritë “Safe” sh.p.k, “A-2000” sh.p.k, “Aulona Pol 1” sh.p.k, “Ballazhi” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Myrto Security” sh.p.k, “Snajper Security” sh.p.k, “Trezhnjeva” sh.p.k, “Oktapus” sh.p.k, “Oktapus 1 Security” sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k dhe Leksi Security” sh.p.k pasi këto shoqëri në ofertën e dhënë nuk përmbushin detyrimet për pagën minimale në ditë, shtesat e turnit të dytë në ditë, shtesat e turnit të tretë në ditë dhe sigurimet shoqërore shëndetësore në ditë dhe nuk kanë paraqitur as analizën e kostove dhe preventivin të plotësuar sipas kërkesës së dhënë në dokumentat e tenderit.

Në DST shtojca 1 Sqarime është kërkuar:

Bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës, të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vendroje me tre turne (4,98 roje), sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike, bazuar në analizën e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

*Analiza e kostos.*

Nr.	Emertimi	Vlera (lek) 1 roje/dite	Vlera (lek) 1 roje/dite 731	Vlera (lek) 1 vendroje me tre turne/dite 731
1.	Shpenzime për pagë bazë			
2.	Shtesë mbi pagë për turnin II			
3.	Shtesë mbi pagë për turnin III			
4.	Shpenzime për sig.shoq.shendet.			
5.	Vlera totale pa tvsh për 1 roje/dite			
6.	Vlera totale me tvsh për 1 roje në ditë			

Sipas analizës së kostos dhe preventivit të dhënë nga AK për koston ditore dhe vlerat duhej të llogariteshin për kolonën vlera 1 roje në ditë zërat e shpenzimeve duhet të jenë në shumën 1.604,21 lekë për roje. Vlerat e shpenzimeve në kolonën vlera për 1 roje/ditë 731 duhet të jenë në shumën  $(1604,21 \times 731) = 1.172.677,51$  lekë. Vlerat e shpenzimeve në kolonën vlera për vendroje me tre turne . ditë 731 duhet të jetë në shumën  $(1.172.677,51 \times 4,98) = 5.839.933,99$  lekë dhe ofertat më pak se kjo vlerë janë nën kosto ligjore.

Pra këto shoqëri zërat e shpenzimeve pagë, shtesa turni, sigurime për kolonën 1 roje/ditë, për kolonën 1 roje/ditë 731, kolonën 1 vendroje me tre turne/ditë 731, i kanë përlllogaritur nën kostot ligjore.

2. Nga ana e AK duhet të skualifikohet shoqëria “Kevenjo” sh.p.k, “Anakonda Security” sh.p.k, “A-2000” sh.p.k, “Siguria” sh.p.k, “Pelikani Security Gropu” sh.p.k pasi nuk kanë përmbushur kërkesën “Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 5 punojës shërbimi , të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë”.

3.Nga ana e AK duhet të skualifikohet shoqëria “Aulona Pol 1” sh.p.k, “Ballazhi” sh.p.k, “Myrto Security” sh.p.k, “Snajper Security” sh.p.k “Res 03” sh.p.k, “Oktapus” sh.p.k, “Oktapus 1 Security”

sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Safe “ sh.p.k, pasi nuk kanë paraqitur formularin e ofertës të dhënë tek shtojca 1, sipas formatit të përcaktuar nga AK për afatin e dhënë:

1	2	3	4	5	6	7
Nr.	Përshkrimi i shërbimit “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të Drjetorisë së Rajonit Qendror Tiranë”	Njësia (muaj)	Sasia (nr.vend rojeve)	Nr. total i rojeve për vendroje	Cmimi njësi/muaj	Oferta në total (neto)
1		(4,98)	(1)	(4,98)	X	
	Oferta neto në total					X
	TVSH (%)					X
	Oferta total					X

4.Nga ana e AK duhet të skualifikohet shoqëria “Res-03” sh.p.k dhe “SSX” sh.p.k pasi certifikatat e QKL, titullar, Drejtues Teknik i kanë fotokopje si dhe nuk kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar për automjetin me qira, ku Leja e Qarkullimit duhet të shoqërohet edhe me kontratën noteriale të marrjes me qira, ku të jetë përcaktuar afati dhe qëllimi i marrjes me qira.”

II.4.. Me anë të shkresës nr.835 prot., datë 21.11.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar atë.

II.5. Në datën 03.12.2018 operatori ekonomik “Dea Security” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.4. Me shkresën me nr.874 prot, datë 11.12.2018, protokolluar me tonën me nr. 1809/2 prot, datë 13.12.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Dea Security” shpk për shoqëritë “Kevenjo” sh.p.k, “Anakonda Security” sh.p.k, “SSX” sh.p.k, “Res-03” sh.p.k, “Siguria” sh.p.k, “Pelikani Security Group” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 15.11.2018, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuara nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i kryer nuk rezulton që këta operatorë ekonomikë të kenë paraqitur ankesë në KPP në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik “Dea Security” shpk, nuk do të merren në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Dea Security” shpk për ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë “Safe” sh.p.k, “A-2000” sh.p.k, “Aulona Pol 1” sh.p.k, “Ballazhi” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k, “Myrto Security” sh.p.k, “Snajper Security” sh.p.k, “Trezhnjeva” sh.p.k, “Oktapus” sh.p.k, “Oktapus 1 Security” sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k dhe “Leksi Security” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.2.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.2.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.2.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomiko – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përlllogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.2.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përlllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimues duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.2.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave, duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t'i kërkojë të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.



Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në Shtojcën 1 “Formulari i ofertës ekonomike”, autoriteti kontraktor ndër te tjera ka përcaktuar:

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimit “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private, te Drejtorisë së Rajonit Qendror Tirane”.	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendr ojeve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi / muaj	Oferta në total (neto)
1.		4.98	(1)	(4.98)	(X)	(X)
	Oferta Neto ne total					
	TVSH (%)					(X)
	Oferta total					(X)

Sqarime:

1. Ne çmim janë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për shërbimin e ruajtjes në një vend roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme.  
*Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.*

*Analize e kostos*

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje / dite	Vlera në leke 1 roje / dite 731	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne / dite 731
1	Shpenzime për pagë bazë			
2	Shtesë mbi pagë për turnin II			
3	Shtesë mbi pagë për turnin III			
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%			
	Vlera totale pa tvsh për 1 roje në ditë			
	Vlera totale me tvsh për 1 roje në ditë			

- *Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.*

- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**). Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek ( e kërkuar ne dokumentat e tenderit )

III.2.9. Ndërkohë në shtojcën 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3 e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

7. Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur. (Shih Shtojca 1 - Sqarime)

III.2.10. Në shtojcën 10 “Shërbimi dhe grafiku i ekzekutimit” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shërbimi që kërkohet: Objekti: “ Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private, te Drejtorisë së Rajonit Qendror Tirane “ – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj ( 731 ditë ).

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj ( i parashikuar ) ( 731 ditë ).

Vendndodhja e shërbimit: Drejtoria e Rajonit Qëndror Tirane

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme	Afati i levrimit
Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private, te Drejtorisë së Rajonit Qendror Tirane.	(T1,T2,T3)	4.98	24 muaj Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 24 muaj. Ose ( 731 ditë ).

III.2.11. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, dokumentacionit të operatorëve ekonomikë si dhe nga shqyrtimi i dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton mangësi dhe paqartësi në procesin e hartimit të dokumentave të tenderit, pasi sikundër është pasqyruar edhe më sipër, në to jepen të dhëna kontradiktore sa i takon detyrimin të ofertuesve për të paraqitur analizën e kostos dhe preventivat për një roje në ditë, për një roje në 731 ditë dhe për një vendroje në 731 ditë, ndërkohë që sipas tabelës së formularit të ofertës ekonomike të dhënat janë kërkuar në muaj. Për më tepër autoriteti kontraktor në kolonën 3 të tabelës së cmimit të ofertës ku është përcaktuar njësia (muaj), ka parashikuar 4,98 (muaj) ndërkohë që kjo shifër i korrespondon numrit të rojeve në një vendroje, ndërsa shërbimi do të kryhet për 24 muaj (731) ditë. Një përcaktim i tillë e vendos Komisionin në një situatë konfuze, sikurse dhe ofertuesit në hartimin e ofertave (e konkretisht lidhur me faktin nëse përllogaritjet duhen bërë bazuar në koston mujore apo ditore), e dhënë e cilat ndikon drejtpërdrejt në ofertën ekonomike të operatorëve ekonomikë pjesmarrës e për këtë shkak duhet të pasqyrohen me saktësi nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, mospërcaktimi i saktë i informacionit të sipërpërmendur, krijon konfuzion tek ofertuesit lidhur me mënyrën e paraqitjes dhe përlllogaritjes së ofertave të tyre ekonomike dhe njëherazi vështirson punën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procesin e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ndërmjet tyre.

III.2.12. KPP gjykon se dokumentat e tenderit duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e shërbimeve, si dhe kërkesave të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e shërbimit të ruajtjes me roje, (pra të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar).

Mungesa e elementëve të sipërcituar shërben si pengesë për konkurrencën e drejtë në prokurimin publik, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të prokurimit publik të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ndaj Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kjo procedurë prokurimi duhet të anulohet, pasi në rastin konkret ndodhemi në kushtet e parashikuara në nenin 64, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: ... b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj.”* Autoriteti kontraktor në rishpallje të saj duhet të përcaktojë qartë informacionin lidhur me numrin e punonjësve të shërbimit, në dokumentat e tenderit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “Dea Security” shpk për procedurën e prokurimit “*Marrëveshje kuadër*” me Nr.REF-88414-10-03-2018 me objekt: “*Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private, te Drejtorisë së Rajonit Qendror Tirane*”, me fond limit 6.143.000 lek pa tvsh, zhvilluar ne datën 01.11.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Qendror Tirane.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe në rishpalljen e saj të korrigjojë shkeljet e konstatuara nga Komisioni i Prokurimit Publik sipas arsyetimit të mësipërm.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Dea Security” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 1809 Protokolli**

**Datë 03.12.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**